



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-057

Prishtinë, më 2 prill 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 2 PRILL 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 mars 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 mars 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 mars 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia diskutoi lidhur me vazhdimin e seancës së ndërprerë, më 29 mars 2012.

Pas diskutimeve, Kryesia vendosi që të mbahet edhe një mbledhje e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, më 3 prill 2012, për të caktuar datën e vazhdimit të punimeve të seancës plenare, të ndërprerë më 29 mars 2012.

Ndërsa, për seancën tjetër të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet, më 12 prill 2012. Rendi i ditës për këtë seancë do të caktohet në mbledhjen tjetër të Kryesisë, me kryetarët e grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës

Sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, e informoi Kryesinë e Kuvendit, në hollësi për të gjitha kategoritë buxhetore, që parashihihen me Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës, për vitin 2013-2015.

Lidhur me Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës, për vitin 2013-2015 diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi shqyrtoi Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës, për vitin 2013-2015, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Korniza afatmesme e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2013-2015 dhe i rekomandohet Ministrisë së Financave, që e njëjta të përfshihet në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, për vitin 2013-2015.
2. Për projektin që ka të bëjë me investimet kapitale në “Vila Gërmija”, do të përgatitet një informatë lidhur me ecurinë e ndërtimit të këtij objekti, që nëpërmjet Kryesisë do të shqyrtohet dhe vendoset në mbledhje plenare të Kuvendit.

Në kuadër të kësaj pike, Kryesia diskutoi edhe për kushtet e punës për deputetët dhe administratën e Kuvendit dhe nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, e cila shfrytëzon hapësirat e Kuvendit, në sipërfaqe prej 570 metra katrorë, që të lirojë një pjesë të Zyrës për ta lidhur horizontalisht aneksin e ndërtesës me pjesën tjetër të objektit të Kuvendit, më qëllim të krijimit të kushteve të punës që deputetët t’i përmbushin detyrimet kushtetuese dhe ligjore.

2 Ftesa e kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjës Jozefina Topalli

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e lartcekur mori, këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-së, nga Kosova, në këtë përbërje: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit dhe Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, në Shqipëri, prej datës 23-24 prill 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi, për të lartpërmendurit, në paragrafin një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3 Njoftimi i kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri

Kryesia u njoftua për vizitën e realizuar të kryetarit dhe nënkryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri dhe Xhavit Haliti, në Shqipëri, prej datës 8-10 mars 2012.

Pika shpeshë:

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Çeki

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit në Çeki. Kryesia kërkoi nga Komisioni që ta zvogëlojë numrin e anëtarëve që do të shkojnë në udhëtim zyrtar në Çeki, ose mund të shkojnë me mjetet e financiare të Komisionit.

4. Të ndryshme:

1. Caktimi i anëtarëve për mbikëqyrjen e punës së Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartpërmendur, caktoi nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Halitin dhe Sabri Hamitin, për ta mbikëqyrur punën e administratës së Kuvendit.

2. Rishqyrtimi i organogramit të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Rishqyrtimi i organogramit të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, u shty për shqyrtim për mbledhjen e radhës të Kryesisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:05** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale